

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“AMIK CONSTRUCTION” SH.P.K.**

Sot, më datën 27.10.2023, **Z. ANDI KASORUHO** i lindur në Durrës, Shqipëri më datë 30 Prill 1969 mbajtës i leternjoftimit me numër personal G90430169H, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “AMIK CONSTRUCTION” Sh. P. K. si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin “AMIK CONSTRUCTION” shpk.

Ortak i kësaj shoqërie është **Z. ANDI KASORUHO**.

Administratore i kësaj shoqërie caktohet **Z. ANDI KASORUHO**, shtetas shqiptar, lindur ne Shqipëri me 30 Prill 1969, i pajisur me NID nr. G90430169H. Z.Kasoruh o emerohet administrator i shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “AMIK CONSTRUCTION” SH.P.K gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh.P.K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “AMIK CONSTRUCTION” SH.P.K. është: **DURRES Lagja 3, Sheshi Liria, Qendra e Biznesit EGT, Kati IV**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Punime,ndertime;
- Vepra të karakterit ndërtimor me konstruksion betoni apo hekuri, marrja e përfaqësisë në fushën e ndërtimit, projektim dhe zbatim punimesh ndërtimi, dizenjim urbanistik;
- Konsultim në aktivitetet e ndërtimit, gërmime dheu, aktivitet i gurorëve;
- Pastrimi në ambjente publike dhe private, izolime, instalim impiante elektrike dhe hidraulike;
- Restaurime dhe mirëmbajtje të pasurive të paluajtshme në pronësi apo të marra nën kujdes;

- Impiante teknologjike, vepra të inxhinierisë së natyrës, aparatura strukturore speciale, barriera dhe mbrojtëse rrugore, struktura të parafabrikuara prej betoni, impiante për përpunimin dhe rekuperimin e mbeturinave;
- Pastrim të sipërfaqeve ujore, detare, liqenore, lumore, linja dhe impiante telefonike, interneti, të rrjetit të telekomunikimit dhe transmetimit;
- Komponente strukturore me përbërje hekuri dhe metali;
- Matje topografike;
- Impiante depurimi;
- Asgjësimi i veprave të ndryshme, gjelbërim dhe rregullim territori, gjurmime arkeologjike;
- Ndërtim të dyshemesë dhe strukturave speciale të sipërme, impiante termike dhe të kondicionimit;
- Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturën e pajisjeve të lëvizshme, rikonstruktime, lotizime, prodhim materiale të ndërtimit dhe të gjitha nëndegëzimet dhe tregtimi i tyre, aktivitet imobiliar, marrja e licensave të ndryshme në çdo aktivitet të ndërtimit apo lëndës së ndërtimit;
- Import-eksport i materiale të ndërtimit, mjeteve motorike të rënda të përdorshme në ndërtim apo në industri të tjera të biznesit, pjesë këmbimi për to;
- Makinerive të përdorshme në ndërtim dhe tregtimi apo dhënia me qera apo tituj të tjerë tek të tretët;
- Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pjesë këmbimi për këto mjete motorike dhe makineri, materialeve të ndërtimit, mallrave të përgjithshme pakufizim që kërkohen në tregun e lirë, tregtimi me pakicë i karburantit dhe nënprodukteve të tij, përdorim direkt ose indirekt i veprave të ndërtuara ose të blera të impianteve dhe të shërbimeve të tyre;
- Shit-blerje, marrje me qira dhe administrim për llogari personale ose të tretëve të veprave publike/private, civile/industriale, rurale/urbane, terrene, pasuri të paluajtshme, hapësira të ndryshme;
- Tregtimi me shumicë e pakicë i materiale të të gjitha kategorive dhe nëndegëzime të tyre që përdoren në ndërtim, makineripajisje të përdorshme në industrinë e ndërtimit, biznese profesionale mbështetëse, biznese shërbimi, bare-restorantehotele-shërbime, materiale elektroshtëpiake, mallrave dhe sendeve që kërkohen në treg dhe ku shoqëria parapëlqen të investojë dhe ushtrojë veprimtari tregtare, shitblerje, depozitim dhe marrje të përfaqësisë për materiale, makineri dhe prodhime të tjera në përgjithësi të lidhura me industrinë e ndërtimit, e pajisjeve industriale dhe të ngjashme me to;
- Zhvillimi i aktivitetit të turizmit në çdo fushë, promovimi, shfrytëzimi i kapacitetit turistik dhe argëtues, agjensi komisionere, punësimi, transporti të çdo lloji për interesin e vet apo të të tretëve, spedicioni, administrimi dhe aktivitet tregtar në gamën e shërbimeve bare-restorante-hotele, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar, operacione që lidhen me pasuri të paluajtshme/luajtshme;
- Të blejë e të shesë, marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri tregtare, ente, konsorciume, shoqëri të thjeshta, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të ngjashëm me shoqërinë, të japë garanci, dorëzani, të marrë hua dhe ofrojë garanci pasurore në favor të të tretëve të jetë palë dhe të ofrojë shërbime, produkte, nëpërmjet të gjitha formave të kontraktimit apo prokurimit publik, marrëveshjeve apo tratativave tregtare apo/dhe me karakter civil, etj;
- Ushtrimi i çdo veprimtarie të ligjshme, të lejueshme për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj;
- Studio projektimi, projektim arktekonik, inxhinierik, studime urbanistike, projektim vepra inxhinierike dhe arti, ndërtime civile dhe industriale, banesa.

## Neni 5

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zoteron një kuote të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

- **Z. ANDI KASORUHO** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**ANDI KASORUHO**

*Andi Kasoruh*

*Akasalo*